

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**LBL Market Albania Sh.p.k.**  
**(shoqeri me ortak te vetem)**

Sot, me 19 Shtator 2017, **shoqeria LBL Market B.V.**, nje shoqeri e themeluar ne Mbreterine e Holandes, e regjistruar ne menyre te rregullt ne Dhomen e Tregtise se Holandes me no. 69318638, dhe me adrese ne Nassaulaan 2A, 2514, Hague, Hollande ("**Ortaku i Vetem**"), me ane te ketij Akti Themelimi themelon nje shoqeri bije te zoteruar teresisht ne Republiken e Shqiperise si vijon:

**I. THEMELIMI**

Neni 1. Emri i Shoqerise

1.1. Emri i Shoqerise qe themelohet ne Republiken e Shqiperise eshte **LBL MARKET Albania sh.p.k.** ("**Shoqeria**").

Neni 2. Forma Ligjore e Shoqerise

2.1. **LBL MARKET Albania** eshte nje shoqeri tregtare dhe person juridik shqiptar, i organizuar ligjerisht si nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.p.k.), ne perputhje me ligjet e Shqiperise dhe dispozitat e Statutit aktual te saj ("**Statuti**").

Neni 3. Selia e Shoqerise

3.1. Selia e regjistruar e Shoqerise eshte ne adresen: Blv Gjergj Fishta, Ndertesa no. 146, Hyrja 1, Kodi Postar 1024, Tirane, Shqiperi. Shoqeria rezervon te drejten te transferoje seline e saj ne nje adrese dhe/ apo ne nje qytet tjeter te Shqiperise.

Neni 4. Kohezgjatja e Shoqerise

4.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

**II. OBJEKTI I SHOQERISE**

Neni 5. Objekti i Shoqerise

5.1. Objekti kryesor i Shoqerise eshte si vijon:



Administrimi, manaxhimi, ngritja e tregjeve, apo pjesemarrja ne shoqeri qe kane si objekt manaxhimin dhe administrimin e tregjeve.

Shitja me shumice dhe pakice e te gjithë llojeve te mallrave, te mirave materiale, apo sherbimeve te lidhura me to.

Veprimtari import-eksport.

Veprimtari sherbimesh, lidhur me objektin kryesor.

5.2. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria mund:

- (i) te kryeje cdo transakcion ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;
- (ii) te bleje ne menyre direkte apo indirekte, aksione te shoqerive te tjera qe kane nje objekt te perafert me ate te Shoqerise, ne Shqiperi ose jashte shtetit;
- (iii) te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi;
- (iv) te kryeje cdo aktivitet tjetër qe mund te konsiderohet i dobishem ose i domosdoshem per te arritur qellimin e aktivitetit te saj.

5.3. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti qe ben pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e mbeshket ate.

5.4. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standardet me te larta te etikës.

### III. KAPITALI THEMELTAR

Neni 6. Kapitali Themeltar

6.1. Kapitali i Shoqerise eshte 200,000 Leke (dyqind mije lek), i perbere nga 1 (nje) Kuote e vetme, e zoteruar teresisht nga Ortaku i vetem, **shoqeria LBL Market B.V.**, nje shoqeri e themeluar ne Mbreterine e Holandes, e regjistruar ne menyre te rregullt ne Dhomen e Tregtise se Hollandes me no. 69318638, dhe me adrese ne Nassaulaan 2A, 2514, Hague, Hollande.

#### IV. ORGANET VENDIMMARRESE TE SHOQERISE

Neni 7.

7.1 Organet Vendimmarrese te Shoqerise jane:

- (i) Asambleja e Pergjithshme;
- (ii) Administratori

#### V. ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 8.

- 8.1. Asambleja e Pergjithshme, e cila perbehet nga Ortaku i Vetem, eshte organi vendimmarres i Shoqerise, i cili merr vendime mbi aktivitetin dhe politiken ekonomike dhe tregtare te saj.
- 8.2. Asambleja e Pergjithshme, e cila perbehet nga Ortaku i Vetem, ka te drejte te marre vendimet ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar ("Ligji Tregtar").
- 8.3. Vendimet e Ortakut te Vetem regjistrohen ne Librin e Vendimeve i cili mbahet ne seline e Shoqerise.

#### VI. ADMINISTRATORI

Neni 9.

- 9.1 Shoqeria drejtohet nga 1 (nje) Administrator i cili eshte perfaqesues ligjor i Shoqerise dhe perfaqeson Shoqerine para te treteve dhe do te jene pergjegjes per veprimtarine e perditshme te shoqerise.
- 9.2 Administratori i Shoqerise do te jete **Z. Besmir Dosti**, shtetas shqiptar, lindur ne Korce, me 08.06.1985, dhe mbajtes i kartes ID no. 024401219.
- 9.3 Kohezgjatja e emerimit te Administratorit te Shoqerise do te jete 3 (tre) vite, me te drejte ripertesitje mandati.



9.4 Administratori ka te drejta te pakufizuara nga Ortaku i Vetem i shoqerise.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 3 (tri) kopje origjinale identike ne shqip dhe ne anglisht secila. Per çdo mosmarreveshje qe lind ne zbatimin dhe/ose interpretimin e ketij Akti Themelimi, versioni Anglisht do te jete i detyrueshem dhe i vetmi qe prodhon efekte ligjore.

**PER ORTAKUN E VETEM**

**LBL MARKET B.V.**

Perfaqsuar nga Z. Besmir Dosti

Besmir Dosti

